



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

DOKUMENT I POLITIKAVE

Çfarë presin gratë nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian?

Nga Gresa Rrahmani, Donikë Kastrati dhe Nicole Farnsworth
për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Prishtinë, Kosovë
dhjetor 2016

Mbështetur nga:

FEMDEFENDERS
KVINNA TILL KVINNA



Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falënderon Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë dhe organizatat anëtare të RrGGK-së të cilat kontribuan në këtë dokument duke sjellur përpara çështjet kyçe me interes për ato. RrGGK poashtu falënderon anëtarët e ekipit: Donikë Kastrati, Gresa Rrahmani, Nicole Farnsworth, Iliriana Banjska dhe Adelina Berisha. Përgatitja e këtij dokumenti, duke përfshirë konsultimet me gratë që kontribuan në dokument, është mbështetur nga Fondacioni *Kvinna till Kvinna*.

Akronimet

BE	Bashkimi Evropian
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit
KEGjFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KE	Komisioni Evropian
LBGj	Ligji për Barazi Gjinore
MASHT	Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
PVGj	Plani i Veprimit Gjinor
QTP	Qendrat e Trajnimit Profesional
RKSOKB 1325	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1325
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
ZP	Zyret e Punësimit

Hyrje

Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë bën thirrje për pjesëmarrje të grave në vendimmarrje në vendet pas konflikteve, siç është Kosova duke theksuar të drejtën e grave në konsultime.¹ Në 'Qasje gjithëpërfshirëse për implementimin nga BE të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 për gratë, paqen dhe sigurinë', Bashkimi Evropian (BE) është përkushtuar për të "promovuar dhe mbështetur pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplotë të grave në të gjitha proceset e paqes, si dhe përfaqësimin e tyre në vendimmarrjen formale dhe joformale në të gjitha nivelet".² BE ka theksuar se barazia gjinore qëndron në thelbin e vlerave të saj dhe se përfshihet në legjislacionin e aplikueshëm dhe politikën.³ *Acquis communautaire* e BE-së për barazi gjinore përfshin disa dispozita të traktateve, legjislacion dhe raste gjyqësore drejt përmirësimit të barazisë gjinore në BE.⁴ Më tutje, nëpërmjet Planit të Veprimit Gjinor (PVGJ) të BE-së për 2016-2020, BE synon të vazhdojë të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe social të grave dhe vajzave, përfshirë këtu edhe në ndalimin e të gjitha formave të dhunës.⁵ Plani i Veprimit Gjinor, iu bën thirrje delegacioneve të BE-së që të arrijnë progres të qartë drejt zbatimit të këtyre objektivave dhe të tjera për barazi gjinore. Për të realizuar këtë Zyra e Bashkimit Evropian ka krijuar mundësi drejt zbatimit të PVGJ-së në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore të shoqërisë dhe siguron mundësi të barabarta të grave dhe burrave në të gjitha sferat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.⁶ Anëtarësimi në Bashkimin Evropian mbetet prioritet i Qeverisë së Kosovës. Vitin e kaluar Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe miratoi Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit në mars të 2016-tës.⁷ Po ashtu, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (LBGJ) thërret që perspektiva gjinore të përfshihet në të gjitha politikën publike, që kërkon analiza gjinore dhe konsultime me gra në mënyrë që prioritet e tyre të reflektojnë në mënyrën e duhur në këto politika.⁸ Pra, çdo politikë ose ligj duke përfshirë edhe ato të draftuara si pjesë e procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE kërkojnë edhe analizat gjinore përkatëse dhe përfshirjen e perspektivës gjinore.

¹ Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 1325, 31 tetor 2000, marrë nga: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N00/720/18/PDF/N0072018.pdf?OpenElement>.

² Këshilli i Bashkimit Evropian, 'Treguesit për qasjen gjithëpërfshirëse për implementimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi gratë, paqen dhe sigurinë nga BE', [*Indicators for the Comprehensive approach to the EU implementation of the United Nations Security Council Resolutions 1325 and 1820 on women, peace and security*] Bruksel: 14 qershor 2010, fq. 8, marrë nga: http://peacewomen.org/sites/default/files/EU_Indicators%20for%20the%20Comprehensive%20approach%20to%20EU%20implementation%20of%201325%20and%201820.pdf.

³ Komisioni Evropian, Dokument punues i përbashkët i stafit, Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020 [*Joint Staff Working Document Gender Equality and Women's Empowerment: Transforming the Lives of Girls and Women through EU External Relations 2016-2020*] në vazhdim të dokumentit i referohemi si PVGJ, f. 2, marrë nga:

https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf

⁴ Për më shumë informata për *acquis për barazi gjinore* drejtoheni tek: Rrjeti Evropian i ekspertëve në fushën e barazisë gjinore, *E drejta evropiane për barazi gjinore*, Përditësim, 2013, [*European Network of Legal Experts in the Field of Gender Equality, EU Gender Equality Law, Update 2013*] Bashkimi Evropian, 2014, marrë nga: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your rights/eu gender equality law update2013_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your%20rights/eu%20gender%20equality%20law%20update2013_en.pdf).

⁵ Po aty, f. 5.

⁶ Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7 (p. 2), marrë nga: <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>.

⁷ Qeveria e Kosovës, 'Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit', Prishtina: Qeveria e Kosovës, 2016, marrë nga: http://www.mei-ks.net/repository/docs/1_pkzmsa_miraturar_nga_kuvendi_final_.pdf.

⁸ Republika e Kosovës, Ligji nr 05/L-020 për Barazi Gjinore, 2015, neni 5 (p.1), marrë nga: <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës është e obliguar që gjatë draftimit të dokumenteve zyrtare të konsultohet me shoqërinë civile, pra me gra dhe burra.⁹

Nga fryma e Rezolutës 1325 dhe në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) në bashkëpunim me Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë,¹⁰ është konsultuar me gra dhe vajza të ndryshme nga e gjithë Kosova. Ky dokument adreson pritshmëritë dhe prioritetet e grave nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe ka për qëllim informimin e akterëve relevantë duke përfshirë por jo vetëm: Zyren e BE-së në Kosovë dhe Qeverinë e Kosovës. Ku është e aplikueshme, RrGGK ka theksuar ku prioritetet e identifikuar nga gratë ndëveprojnë me politikat e BE-së dhe të Kosovës në lidhje me barazinë gjinore. Ky dokument mund të informoj politikat dhe ndryshimet e programeve të ardhshme të cilat drejtpërdrejtë dhe/ose tërthorazi ndikojnë në jetën e grave dhe vajzave në Kosovë.

Rekomandimet

Nisur nga konsultimet e organizuara me gra të ndryshme përgjatë Kosovës, RrGGK dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë identifikuar rekomandimet e mëposhtme për Zyren e BE-së në Kosovë dhe institucionet kosovare, për tu marrë në konsideratë në lidhje me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Për Bashkimin Evropian

- **Të inkurajohet dhe mbështetet politikisht dhe financiarisht** Qeveria e Kosovës për të adresuar rekomandimet e mëposhtme në pajtim me *acquis communautaire* të BE-së për barazi gjinore dhe Planin e Veprimit Gjinor të BE-së.
- **Të inkurajohet zbatimi i legjislacionit në fuqi kundër ndikimit politik në punësim, nepotizmit dhe korrupsionit.** Komisioni Evropian (KE) në Raportin për Kosovën për 2016 ka theksuar se korrupsioni “vazhdon të jetë i përhapur dhe problem shumë serioz në Kosovë dhe se një vullnet më i fuqishëm politik është mëse i nevojshëm për të luftuar atë”.¹¹ Shëndetësia, arsimimi dhe gjyqësia janë veçanërisht të prirura për korrupsion. ¹² Prokuroria, gjykatat dhe autoritetet e tjera përkatëse të jenë më efikase në ndërmarrjen e masave në raste të evidentimit të dukurive tilla të cilat janë të ndaluara dhe të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi.
- **Të inkurajohet Qeveria e Kosovës të harmonizoj ligjet për zgjedhjet me LBGJ.** Komisioni Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, Komisioni për Integritet Evropian si dhe Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione duhet të iniciojnë amandamentimin e Ligjit nr. 03/L-073 për

⁹ Republika e Kosovës, Qeveria, Rregullore (qrk) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, 2016, marrë nga:

http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Regullore_QRK_Nr_052016_per_standardet_minimale_per_procesin_e_konsultimit_public.pdf.

¹⁰ Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë mbledh bashkë gra dhe burra nga shoqëria civile dhe politika nga 27 komuna të Kosovës për të avokuar për barazi gjinore në Kosovë pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësitë, fenë, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik (<http://www.womensnetwork.org/?message=true&FaqlID=1&n=250>).

¹¹ Komisioni Evropian, Dokument punues i stafit, Raporti për Kosovën për 2016, [Commission Staff Working Document Kosovo 2016 Report] f. 5, marrë nga:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf.

¹² Po aty, f.19.

Zgjedhjet e Përgjithshme¹³ dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale¹⁴ që të jetë në përputhje me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore i cili definon përfaqësimin e barabartë (50%) të grave dhe burrave në të gjitha fushat duke përfshirë dhe asambljetë komunale dhe parlamentin e Kosovës.¹⁵ Sipas Raportit e KE-së për Kosovën gratë vazhdojnë të mbesin të nën-përfaqësuara në pozitat vendimmarrëse.¹⁶ PVGJ parasheh të drejta të barabarta për gratë, mundësinë që gratë të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes,¹⁷ duke mbështetur legjislacionin i cili synon të shemb pengesat për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEGjFDG), Rezolutën 1325, Platformën e Pekinit dhe Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

- **Të inkurajohet zbatimi i Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në të gjitha sektorët dhe të ju jepen mundësi të barabarta si grave ashtu edhe burrave.** Në përputhje me KEGjFDG, Rezolutën 1325 të Kombeve të Bashkuara, Platformën e Pekinit dhe Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Po ashtu, siç është theksuar edhe në Raportin e KE-së për Kosovën se zbatimi i LBGJ-së vazhdon të mbetet i ngadalshëm dhe legjislacioni sekondar lidhur me barazinë gjinore ende nuk është miratuar.¹⁸ Moszbatimi i ligjit dëmton të drejtat e grave dhe burrave dhe thëllon pabarazitë. Si pjesë e reformës së vazhdueshme administrative, Zyra e BE-së mund të inkurajoj Qeverinë e Kosovës të ndërmarrë masa afirmative për respektimin e kuotës gjinore gjatë punësimit në pajtim me LBGJ-në.
- **Të mbështetet institucionalizimi i statistikave gjinore në Kosovë, duke përfshirë edhe të dhëna për hendekun gjinor të pagës.** Kosova ende nuk ka statistika të sakta rreth hendekut gjinor të pagës në mesin e statistikave të tjera gjinore të rëndësishme.¹⁹ Direktiva 2006/54/KE e riafirmon parimin për pagë të barabartë për punën e njejtë ose punën e vlerës së njejtë të mishëruar edhe në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian,²⁰ parim ky i cili është i inkuoruar edhe në LBGJ, por të dhëna më të mira duhen për të monitoruar zbatimin.²¹ Sipas LBGJ-së, institucionet e Kosovës duhet të angazhohen në analiza gjinore të statusit të grave, burrave, vajzave dhe djemve në fushat përkatëse.²² PVGJ gjithashtu i inkurajon delegacionet e BE-së të mbështesin zhvillimin e aftësive për analiza gjinore të agjencioneve nacionale të statistikave.²³

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- **Të adresohet diskriminimi gjinor gjatë punësimit dhe në vendin e punës si dhe të adresohet puna pa kontratë të punës.** Praktikrat aktuale që ekzistojnë në Kosovë ndikojnë në diskriminim ndaj grave gjatë punësimit dhe në vendin e punës.²⁴ Për më tepër afër 20% e të punësuarve dhe 48% e të rinjëve punojnë

¹³ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf.

¹⁴ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, marrë nga: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L072_al.pdf.

¹⁵ Ligji për Barazi Gjinore, neni 3(1.15).

¹⁶ Komisioni Evropian, Dokument punues i stafit, Raporti për Kosovën për 2015, [Commission Staff Working Document Kosovo 2015 Report] f. 24, marrë nga: http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf.

¹⁷ PVGJ 2016-2020, f. 26.

¹⁸ Raporti për Kosovën për 2016, f. 26.

¹⁹ Për më shumë detaje në lidhje me fusha tjera shihni RrGGK 'Krijimi i indeksit të BE-së për Barazi Gjinore në Kosovë', Dokument diskutimi, Prishtina: RrGGK, 2016.

²⁰ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Neni. 157 (neni i mëparshëm 119 KEE, neni i mëparshëm 141 KE), 1958.

²¹ Ligji për Barazi Gjinore, neni 17 (1.12).

²² Po aty, neni 5 (1.1).

²³ PVGJ 2016-2020, aktiviteti 6.1, f. 25.

²⁴ Për më shumë shih Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, "Arritja e ekuilibrit" Opsionet e politikave që synojnë të informojmë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë, Prishtinë, 2016 marrë nga:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20160504154201554.pdf>.

pa kontratë.²⁵ Në përputhje me KEGjFDG, Direktivën e BE-së 2006/54/EC, dhe LBGJ shteti ka për obligim të ndërmarr masa efektive të cilat adresojnë diskriminimin gjinor. Puna pa kontratë është e kundërligjshme,²⁶ dhe në dëm të punëtorit/es. Inspektorati i punës duhet të hetoj format e ndryshme të diskriminimit gjinor dhe shkeljet e Ligjit të punës sidomos në sektorin privat. Hulmtimi i mëparshëm i RrGGK-së sygjeron se inspektorati nuk i ka hetuar sa duhet diskriminimin gjinor përfshirë lidhur me sigurinë në punë të grave shtatëzëna, pushimin e lehonisë dhe praktikatat e diskriminimit gjatë aplikimit për punë.²⁷

- **Të adresohet pushimi prindëror me amandamentimin e Ligjit nr. 03/L-212 të Punës.** Dispozitat e tanishme të pushimit të lehonisë në Ligjin e Punës duket se kontribuojnë në diskriminimin ndaj grave në punësim dhe vendin e punës.²⁸ Andaj Ligji i ri i Punës duhet të amandamentoj pushim prindëror, veçanërisht dispozitat lidhur me pushimin e lehonisë, atësisë dhe pushimin prindëror.²⁹ Më tutje, Ligji i tanishëm i Punës diskriminon ndaj burrave dhe të drejtën e tyre të barabartë për pushim më të gjatë prindëror të paguar, sic parashihet me LBGJ. Amandamentimet e Ligjit të Punës duhet të shqyrtohen për të siguruar që janë në përputhje me Direktivën e Këshillit Evropian 2010/18/BE mbi pushimin prindëror, Direktivën 92/85/KE për punëtoret shtatëzëna dhe Direktivën 2006/54/KE mbi mundësitë dhe trajtimin e barabartë të grave dhe burrave në çështjet e punësimit dhe profesionit. Familjeve do të duhej tu jepej mundësia të ndajnë pushimin barabartë në mes të burrave dhe grave. Kjo do të mund të kontribuonte në ndërrimin e normave tradicionale gjinore lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe të lehtësojë ngritjen e shkallës së punësimit të grave dhe adresimin e diskriminimit gjinor.³⁰
- **Të fuqizohet Inspektorati i punës në pajtim me Ligjin për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9 si dhe të rritet përqindja e inspektorëve në pajtim me Ligjin nr.05/L-020 për Barazi Gjinore.** Hulmtimi i RrGGK tregon se në vitet 2012 dhe 2013 kishte më pak inspektime të grave të punësuar (22% dhe 25% përkatësisht) sesa të burrave të punësuar (78% dhe 75%) nga inspektorët e punës.³¹ Inspektorati i Punës brenda MPMS-së duhet të sigurojë që inspektorët trajnohen mbi kornizën ligjore lidhur me diskriminimin gjinor në punësim, vendin e punës dhe shkarkimin nga puna. Gjithashtu, inspektorët e punës duhet të adresojnë format tjera të shkeljes së Ligjit të Punës, siç janë puna pa kontratë dhe mos-kompenzimi i punës jashtë orarit.³² Rritja e numrit të inspektorëve (përfshirë veprimet afirmative për punësimin e grave inspektore në pajtim me LBGJ) do të mund të lehtësojë zbatimin e Ligjit të Punës. Edhe Raporti i KE-së për Kosovën për 2016 ka rekomanduar rritjen e numrit të inspektorëve të punës.³³
- **Të rritet numri i grave dhe vajzave të cilat regjistrohen në Zyrën e Punësimit (ZP) dhe të cilat përfitojnë nga Qendrat e Trajnimit Profesional (QTP).** Të aftësohen gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në ato fusha në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe të hartohen politika përkatëse për rritjen e numrit të vajzave dhe djemve në shkollat profesionale. Më pak gra sesa burra regjistrohen në ZP-së dhe QTP-së ndonëse

²⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e fuqisë punëtore, TMI 2016, marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/media/2477/afp-tm1-2016-shqip.pdf>

²⁶ Republika e Kosovës, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, marrë nga:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-212-alb.pdf>.

²⁷ Për më shumë shih RrGGK, "Arritja e ekuilibrit".

²⁸ RrGGK, "Arritja e Ekuilibrit" Opsionet e politikave që synojnë të informojmë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë, f. 5.

²⁹ Raporti për Kosovën për 2016, f. 52.

³⁰ RrGGK, "Arritja e Ekuilibrit", f. 32.

³¹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, Analizë e shpejtë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë, Prishtinë, 2014, f. 18 marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140702111943317.pdf>.

³² RrGGK, "Arritja e Ekuilibrit", f. 40.

³³ Raporti për Kosovën për 2016, f. 51.

gratë kanë shkallë më të lartë të papunësisë.³⁴ Direktiva 2006/54/KE përcakton zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në qasjen në punësim dhe trajnim profesional.³⁵ Edhe PVGJ parasheh “qasje të barabartë për gratë dhe vajzat në të gjitha nivelet e edukimit kualitativ, arsimit dhe trajnimit profesional të liruar nga diskriminimi”.³⁶ PVGJ gjithashtu inkurajon BE-në të mbështets në edukimin dhe trajnimin profesional të rinjëve, zhvillimin e aftësive dhe programeve të tjera aktive në tregun e punës.³⁷ Në pajtim me LBGJ, MPMS duhet të ndërmerr masa të veçanta për të adresuar pabarazitë gjinore të cilat ekzistojnë në fushën e punësimin.

- **Të organizohen fushata vetëdijesuese për luftimin e stereotipeve gjinore në zgjedhjen e profesionit dhe punës.** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Qendrat për Aftësim Profesional, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) si dhe ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse duhet të angazhohen për luftimin e stereotipeve gjinore në punë dhe profesion. Steriotipet gjinore lidhen poashtu me mosbalancimin e grave dhe burrave në sektorë të caktuar, që ndikon në moszbatimin e LBGJ-së edhe në lidhje me përfaqësimin e barabartë edhe në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. MPMS-ja mund të organizojë fushata ndërgjegjësimi drejt transformimit të roleve stereotipike gjinore në sektorë të caktuar. Plani i Veprimtimit Gjinor të BE-së inkurajon mbështetje drejt ngritjes së vetëdijësimin siç janë, “duke punuar së bashku me operatorët e mediave për të rritur vetëdijësimin e tyre dhe të publikut për barazi gjinore”³⁸, dhe si aktivitete potenciale liston “ofrimin e edukimit (formal dhe jo-formal) i cili i adreson stereotipet gjinore”.³⁹
- **Të vazhdohet mbështetja për klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelizimin e pagave në të gjitha institucionet.** Klasifikimi i vendeve të punës duhet të bazohet në kritere të njejta si për gra ashtu edhe për burra në përputhje me LBGJ dhe Direktivën 2006/54/KE për zbatimin e parimit të trajtimit dhe mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në çështjet e punësimin dhe profesionit.⁴⁰
- **Të investohet në shtëpi të kujdesit ditorë dhe të përhershëm për të moshuarit.** Në Kosovë ka mungesë të shtëpive të kujdesit për të moshuarit në krahasim me madhësinë e mundshme të të moshuarve me vetëm tri shtëpi për persona të moshuar (në Prishtinë, Gurakoc, dhe Skenderaj) dhe një shtëpi të komunitetit në Graçanicë.⁴¹ Kriteret për t'u pranuar në këto shtëpi janë shumë të rrepta që “të gjithë personat e vendosur në shtëpitë e të moshuarve të jenë mbi moshën 65 vjeç, të mos kenë pasardhës biologjikë apo të birësuar, dhe të jenë në gjendje të mirë mendore”.⁴² MPMS, Qeveria e Kosovës, komunat duhet të investojë në qendra të kujdesit qoftë ditore apo të përhershme, me kritere më pak të rrepta që të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pavarësisë së personave të moshuar. Kjo gjithashtu do të ndikojë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe t'u mundësojë personave që aktualisht kujdesen për personat e moshuar të marrin pjesë në fuqinë punëtore.

³⁴ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, Analizë gjinore+ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016-2018, Prishtinë, 2015, f. 4, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20151203094304881.pdf>.

³⁵ Parlamenti Evropian, Direktiva 2006/54/KE mbi Zbatimin e Parimit të Mundësive të Barabarta dhe Trajtimin e Barabartë të Burrave dhe Grave në Çështjet e Punësimin dhe Profesionit, neni I, marrë nga: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:204:0023:0036:en:PDF>

³⁶ PVGJ 2016-2010, f. 30.

³⁷ Ibid.

³⁸ Po aty, f. 25.

³⁹ Po aty, f. 30.

⁴⁰ Parlamenti Evropian, Direktiva 2006/54/KE Mbi Zbatimin e Parimit të Mundësive të Barabarta dhe Trajtimin e Barabartë të Burrave dhe Grave në Çështjet e Punësimin dhe Profesionit, neni I.

⁴¹ RrGGK, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, 2015, f. 39.

⁴² Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr 10/2014, 2014, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10414>.

Për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë

- Të rritet numri i qendrave të kujdesit për fëmijë në proporcion me numrin e fëmijëve në nevojë. Në kuadër të këtyre qendrave të kujdesit duhet të ndërmerren masa që të ketë kujdes cilësor për vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara. Anketa e fuqisë punëtore si dhe anketat e RrGGK në ekonomi familjare tregojnë se përgjegjësitë familjare dhe kujdesi për fëmijët janë ndër arsyet pse gratë janë më pak aktive në tregun e punës sesa burrat.⁴³ Qasja e kufizuar në çerdhe dhe marrëveshje fleksibile të punës janë gjetur gjithashtu të jenë barriera që lidhen me punësimin e grave sipas Raportit të KE-së për Kosovën. Rritja e disponueshmërisë së qendrave të kujdesit ndaj fëmijëve do të lehtësonte pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe përmirësonte arritjet shkollore të fëmijëve.⁴⁴ Kosova qëndron larg Objektivave të Barcelonës të BE-së, lidhur me synimin e ofrimit të qendrave të kujdesit për fëmijë për moshën nën tre vjeç për 33% dhe për fëmijët mbi tre vjeç deri në fillimin e shkollimit fillor deri në 90%.⁴⁵ Gjatë vitit shkollor 2015-2016 rreth 24,309 fëmijë nën moshën tre vjeç dhe 60,118 fëmijë të moshës tre deri në gjashtë vjeç ende kanë nevojë për kujdes, sipas Objektivave të Barcelonës.⁴⁶ Për më tepër dëshmitë sugjerojnë se fëmijët të cilët vijnë institucionet parashkollore janë më të suksesshëm në shkollë. Rritja e numrit të çerdheve është prioritet edhe i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2017, duke synuar të rris numrin e përfshirjes së fëmijëve nëpër kopshte publike dhe private.⁴⁷ Krijimi i hapsirave të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara do të kontribuonte në përmirësimin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e edukimit.⁴⁸
- Të bëhet inspektimi i çerdheve se sa po e zbatojnë legjislacionin mbi edukimin parashkollor. MASHT përkatësisht Inspektoriati i Arsimit duhet të vazhdojë inspektin e detajizuar dhe të rregullt se sa po zbatohet legjislacioni mbi edukimin parashkollor. Raporti i KE-së për Kosovën për 2016 ka theksuar dhe zbatimin e legjislacionit për të drejtat e fëmijëve mbetet sfidë.⁴⁹
- Të përmirsohet infrastruktura nëpër shkolla (me kabinete, salla sportive, laboratore) dhe të adresohen stereotipet gjinore ekzistuese në librat shkollorë dhe librat universitarë. Shkollat kosovare përballen me probleme infrastrukturale, siç janë mungesa e sistemeve të përshtatshme të ngrohjes dhe ftohjes dhe kushteve sanitare dhe higjienike në tualete.⁵⁰ Ky lloj i mjedisit ku vajzat dhe djemtë shkollohen mund të dëmtojë aftësinë e nxënësve për të mësuar. MASHT së bashku me komunat duhet të adresojë këtë problem duke planifikuar dhe prioritetizuar investimin në infrastrukturën

⁴³Agjencia e Kosovës për Statistika, Anketa e fuqisë punëtore për 2015, 2016. Po ashtu, raporti i RrGGK-së *Kush kujdeset?* tregon se ato shpesh nuk punësohen për arsye të obligimeve në kujdesin ndaj fëmijëve (*Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë*, RrGGK, Prishtinë, 2016, marrë në: <http://womensnetwork.org/documents/20161103153827186.pdf>).

⁴⁴ Për më shumë informata, shih: *Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë*, RrGGK, Prishtinë, 2016.

⁴⁵ Objektivat e Barcelonës përcaktojnë se: Shtetet Anëtare duhet të heqin pengesat për pjesëmarrjen e kraut të punës nga radhët e grave, duke marrë parasysh kërkesën për qendra të kujdesit për fëmijë dhe në pajtim me modelet kombëtare të ofrimit, për të ofruar kujdes për fëmijë deri në vitin 2010 për të paktën 90% të fëmijëve nga 3 vjeç deri në moshën kur ndjekja e shkollës bëhet e detyrueshme dhe për të paktën 33% të fëmijëve nën 3 vjeç. Për më shumë: Objektivat e BE-së të Barcelonës: Zhvillimi i objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve, për fëmijët e vegjël në Evropë, në vështrim të rritjes së qëndrueshme dhe përfshirëse [The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth], f. 5, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/130531_barcelona_en.pdf.

⁴⁶ RrGGK, *Kush kujdeset?*, f. 19.

⁴⁷ Republika e Kosovës, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021 (SKZH), f. 12, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁴⁸ Problemi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e edukimit është ngritur edhe në Raportin e KE-së për Kosovën për 2016, f. 27.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ RrGGK, Buxhetingu për një arsimim më të mirë: Analizë e përgjithshme e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2016, f. 32 marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20160607151528451.pdf>.

arsimore,⁵¹ në pajtim me Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës. Sipas një shqyrtimi të bërë nga RrGGK vlerësohet se librat e tanishëm shkollorë dhe universitarë përmbajnë shumë stereotipe gjinore. MASHT duhet të rishqyrtoj librat duke inkorporuar perspektivën gjinore dhe të heq këto stereotipe nga tekstet shkollorë dhe universitare në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.⁵² MASHT mund t'i drejtohet BE-së në pajtim me Instrumentin për Ndhimën e Para-Anëtarësimit (IPA) për të financuar përmirësimin e kualitetit të arsimit. Gjithashtu, PVGj inkurajon "mbështetje legjislacionit dhe kapacitetit kombëtar në mbulim të plotë të cilsisë dhe arsimit jo diskriminues" dhe "si aktivitetet potenciale liston ofrimin e edukimit (formal dhe jo-formal) i cili i adreson stereotipet gjinore".⁵³

- **Të ju sigurohet transporti vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuar për të vijuar mësimin.** MASHT së bashku me komunitet duhet të ndajë buxhet dhe tu ofrojë transport falas vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuar për të vijuar mësimin. Mungesa e transportit për të ndjekur mësimin është një nga barrierat e shumta me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara.⁵⁴ Në bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës shtetet njohin të drejtën e fëmijës me aftësi të kufizuara për kujdes të veçantë dhe duhet të ofrojë ndihmë falas sa herë që është e mundur që fëmija të ketë në mes tjerash qasje efektive në edukim.⁵⁵ Ndërsa, PVGj inkurajon "qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit".⁵⁶
- **Të rritet numri i psikologëve dhe pedagogëve në shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe të larta dhe shkolla profesionale sipas nevojës.** Psikologu në shkolla është shumë i rëndësishëm në zhvillimin dhe shëndetin mendor dhe fizik të vajzave dhe djemve si dhe në ndihmën për rritjen e cilësisë së procesit të mësimin.⁵⁷ Çdo shkollë duhet të ketë qasje në psikolog dhe shkollat në vendet rurale mund të ndajë një psikolog në periudha kohore të caktuara. Edhe Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës parasheh praninë e psikologëve dhe pedagogëve në institucionet arsimore.⁵⁸ Ky shqetësim është ngritur veçanërisht nga aktivistet vajza lidhur me rëndësinë e psikologut në shkolla, ndoshta edhe në bazë rotacioni për shkollat më të vogla për tu përfshirë si një veprim i rëndësishëm për të parandalimin e braktisjes së shkollës dhe identifikimin e dhunës në familje dhe ngacmimit seksual.⁵⁹

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- **Përmirësimi i inspektimeve shëndetësore.** Hulumtimi i RrGGK-së ka nxjerr në pah nevojën që inspektorët të inspektojnë farmacitë dhe klinikat private të paregjistruara.⁶⁰ Gjersa BE ju ofron vendeve anëtare autonomi lidhur me qeverisjen e kujdesit shëndetësor, ekzistojnë disa parime që shtetet anëtare duhet të ndjekin. Përkatesisht e drejta për mosdiskriminim mund të shërbejë si bazë për sigurimin e njerëzve që të kenë qasje në kujdesin shëndetësor, pa asnjë lloj diskriminimi.⁶¹ Inspektorët duhet të sigurojnë që të

⁵¹ Po aty.

⁵² Ligji për Barazi Gjinore, neni 21.

⁵³ PVGJ 2016-2020, f. 30.

⁵⁴ Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2015, f. 62, në:

http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2015_IAP_FINAL_351292.pdf.

⁵⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990, neni 23, në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>.

⁵⁶ PVGJ 2016-2020, f. 31.

⁵⁷ Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Arsimi Gjithëpërfshirës e Drejtë e Secilit*, 2014, fq.8, marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/arsimimi-06-06-2014-3.pdf>.

⁵⁸ Republika e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 37 marrë nga: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>.

⁵⁹ Ky shqetësim është ngritur gjatë takimeve me vajza dhe djem në FemAct, 2015.

⁶⁰ RrGGK, "Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë", Prishtinë, 2016, raport i cili do të publikohet së shpejti.

⁶¹ Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, 2009, neni. 10 dhe neni. 19, dhe Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian, neni. 3.

drejtat e të gjithëve lidhur me kujdesin shëndetësor të mbrojtura nga legjislacioni vendor nuk shkelen, që lidhet me sundimin e ligjit,⁶² që është me rëndësi për anëtarësimin e Kosovës në BE.

- Të përfundohet procesi i modernizimit të Sistemit Informativ Shëndetësor (SIS) që duhet të përfundoj para 2020tës, përfshirë digjitalizimin e mbledhjes së sigurtë të të dhënave dhe menaxhimin në të gjitha komunat që mbron të drejtat e pacientëve në privatësi. Poashtu, në mënyrë që të bëhet një raportim i rregullt dhe i saktë të mbahen trajnime mbi funksionimin e këtij sistemi për personat përgjegjës në institucione. Një SIS funksional do të mundësonte informacion më të mirë dhe kualitativ lidhur me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, që do të mund të informonte politikbërjen. Mbështetja e zhvillimit të statistikave gjinore do të ishte në pajtim me LBGJ,⁶³ dhe inkurajohet edhe me Planin e Veprimit Gjinor.⁶⁴

Për Ministrinë e Bujqësisë e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (MBPZh)

- Të bëhet ngritja e subvencioneve për gratë fermere. Ministria e Bujqësisë e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural dhe Qeveria e Kosovës nëpërmjet masave afirmative mund të ndikojnë në fuqizimin ekonomik të grave duke ngritur numrin e subvencioneve të ndara për gratë fermere apo duke inkorporuar kuota gjinore gjatë ndarjes së këtyre subvencioneve në të gjitha fushat. Kjo do të mund të përkrahej edhe me anë të IPA-së. Aktivistet për të drejtat e grave kanë vëzhguar se kushti i cili kërkon që aplikuesi/ja i/e subvencioneve të ketë diplomën e shkollës së mesme e vështirson shumë qasjen e grave në subvencione. Heqja e këtij kushti për disa programe të caktuara do ta lehtësonte qasjen e grave në këto subvencione. Fuqizimi ekonomik i grave është poashtu një nga qëllimet e PVGJ, i cili inkurajon përkrahje për gratë sipërmarrëse si dhe eliminimin e pengesave për pjesëmarrjen e grave në tregje, në sektorin privat, në shërbime financiare etj.⁶⁵

Për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

- Të mbështeten bizneset e vogla dhe të mesme të grave. Përqindja e bizneseve në pronë të grave vazhdon të jetë e ulët,⁶⁶ dhe masa të veçanta janë të nevojshme të ndërmerren për të adresuar këtë në pajtim me LBGJ dhe praktikat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Nëse Ministria vazhdon të pranoj financime nga IPA, mund të vendos masa afirmative për të inkurajuar dhe mbështetur më shumë biznese në pronësi të grave përmes kuotave në programet ekzistuese të subvencionimit, pike shtesë në proceset e pikëve, apo programe special që synojnë të adresojnë nën-përfaqësimin e grave në mesin e pronarëve të bizneseve. PVGJ parasheh këto forma të mbështetjes së fuqizimit ekonomik të grave, përfshirë "qasje e barabartë e grave në shërbimet financiare, dhe në përdorimin, dhe në kontrollimin e tokës dhe burimeve të tjera prodhuese, si dhe mbështetje për gratë sipërmarrëse".⁶⁷

Për Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatat, Notaritetë

- Të zbatohet Ligji nr. 2004/26 për Trashëgiminë dhe legjislacioni në fuqi që lidhet me pronën dhe trashëgiminë si dhe regjistrimin e trashëgimisë *ex officio*. Gratë dhe vajzat në Kosovë ende nuk

⁶² Për më shumë informacione në lidhje me shkeljet e të drejtave, shih RrGGK, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*.

⁶³ Ligji për Barazi Gjinore, neni 5.

⁶⁴ PVGJ 2016-2020, f.26.

⁶⁵ Po aty, f. 33.

⁶⁶ RrGGK, *Buxheti për Barazi Gjinore në Tregti dhe Industri*, Prishtinë, 2016, f. 36 marrë nga:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20161108210425853.pdf>.

⁶⁷ PVGJ 2016-2020, f. 9.

gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi. Zbatimi i legjislacionit në praktikë mbetet i limituar dhe si pasojë dëmton fuqizimin ekonomik të grave.⁶⁸ Reforma ligjore e ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë lidhur me Kodin Civil, duhet të reflektojë perspektivën gjinore dhe hartimi i ligjeve duhet të jetë sensitiv nga aspekti gjinor në mënyrë që të adresojë diskriminimin e grave të cilave i'u mohohet e drejta në gëzimin e pronës. BE mund të vazhdoj mbështetjen për zhvillimin e politikave për zbatimin e ligjit për trashëgiminë si dhe të vazhdoj të inkurajoj implementimin e ligjeve nga gjykatat dhe notaritë.

⁶⁸ Raporti për Kosovën për 2016, f. 27.